



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 62, Datë 23.04.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SH.P.K. PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 46 DATË, 19.03.2019 “MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “OSHEE” SH.A. PËR SHTYRJEN PËR NJË PERIUdhË
TRANZITORE TË AFATIT TË PAGESËS SË FATURAVE PËR BLERJEN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR, NGA ANA E OSHEE
SH.A. DHE ÇËSHTJE TË TJERA TË RREGULLIMIT”.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 53, nenit 56 dhe nenit 59 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenit 16 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2019 mbasi shqyrtoi arsyetimin dhe spjegimet e relacionit të Drejtorive Teknike, pjesë integrale e këtij vendimi, mbi kërkesën e shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46 datë, 19.03.2019,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. me anë të shkresës së saj nr. 64/18 Prot., datë 03.04.2019, ka përcjellë në ERE kërkesën për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46 datë, 19.03.2019 “Mbi kërkesën e shoqërisë “OSHEE” sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e “OSHEE” sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit”.
- Shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e Licencës nr.74 Seria T08P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.130, datë 02.12.2008, për një afat 5-vjeçar dhe rinovuar së fundmi me Vendimin nr. 202, datë 13.09.2018 të Bordit të ERE-s.
- Në kuptim të vendimit ndaj të cilit është kërkuar rishikim, kërkuesi legjitimohet në cilësinë e palës së interesit.
- Për sa i përket afateve të depozitimit të një kërkesë për rishikim të vendimeve të ERE-s, *Rregullorja e Organizimit Funkcionimit dhe Procedurave të ERE* miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, parashikon:

Neni 16 - Ridëgjimi dhe Ankimi kundër vendimit të Bordit 1. Për një Vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brënda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k., siç provohet nga procesverbali i mbledhjes së datës 19.03.2019, është përfaqësuar në mbledhjen e Bordit të ERE-s me anë të përfaqësuesit të saj z. Sokol Spahia, i cili ka marrë dijani rregullisht në lidhje me vendimmarrjen e Bordit, dhe ka parashtruar argumentimet e tij në lidhje me këtë vendimmarrje.
- Neni 149 i ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative parashikon se : Njoftimi që i bëhet përfaqësuesit ose personit përgjegjës të njoftimeve, vlerësohet se i është bërë personalisht palës (procesverbali I nënshkruar nga përfaqësuesi I GEN-I Tirana sh.p.k Z.Sokol Spahia)
- Kërkesa për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nga shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k., nuk reflekton parashikimet e nenit 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, që parashikon një afat prej 7 ditësh kalendarikë për depozitimin e kërkesës për rishikim të një vendimi të Bordit të ERE-s, referuar datës së marrjes dijani mbi të. Kërkesa është depozituar 14 ditë pas marrjes dijani (shkresa e “GEN-I Tirana” sh.p.k. me nr. 64/18 prot, datë 03.04.2019).
- Së bashku me kërkesën për rishikim, shoqëria GEN-I Tirana Sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresat si më poshtë:
 - Shkresë: Tiranë, 2 Prill, 2019 nr. Ref. 607/2019/MP;
 - Vendimi i Bordit të ERE-s, nr.26, datë 28.02.2019;
 - Letër e ERE-s për OSHEE-në dhe GEN-I Tirana Nr. 64, datë 23 01.2019;
 - Letër e GEN-I Tirana për ERE-n, datë 21.12.2018;
 - Letra e ERE-s për GEN-I Tirana nr. prot. 64/13, datë 07.03.2019;
 - Vendim i Bordit të ERE-s me nr.46 datë, 19.03.2019 ;
- Të gjitha dokumentat bashkëlidhur, janë dokumenta ose të lëshuara nga ERE, drejtuar apo në dijani të ERE-s, ose vendimmarrje të Bordit të ERE-s përpara marrjes së vendimit për të cilin është kërkuar rishikimi..
- Në këtë kuptim, asnjë nga dokumentat bashkëlidhur nuk përbën prove të re, që mund ta çojë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.
- Për sa i përket argumentave të përdorur për të kërkuar rishikimin e vendimit nga pala kërkuese e rishikimit, asnjëri prej tyre, nuk është apo përbën një provë apo argument të ri.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Gen-I Tirana" sh.p.k. për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.03.2019 "Mbi kërkesën e shoqërisë "OSHEE" sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e "OSHEE" sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit", si të pambështetur në prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara në kuptim të nenit 16 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".
2. Drejtorja e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë kërkuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI